

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**Ap-Kz nr. 325/2011**  
**19 qershor 2012**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit, gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe gjyqtarës së Gjykatës Supreme Emine Mustafa, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore Chiara Rojek në cilësi të procesmbajtëses.

Në lëndën penale kundër R. K., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin *vendi...*, Komuna e Plavës, emri i babait A. K., mbiemri i vajzërisë së nënës N. K., me nënshtetësi të Kosovës, aktualisht me vendbanim në *adresa ...*, Pejë, pronar i kompanisë ... (biznesmen), i martuar, baba i katër fëmijëve, ka mbaruar shkollën e mesme komerciale, din shkrim dhe lexim, me gjendje të dobët ekonomike.

Dhe dy të pandehurve të tjerë.

Të akuzuar sipas aktakuzës PP 480-5/2007 të paraqitur më 17 korrik 2007, të konfirmuar me anë të aktvendimit KA nr. 132/08 të datës 15 shkurt 2008, për veprën penale Ndhimë në Shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit në kundërshtim të neneve 25 dhe 339 paragrafëve 1 dhe 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK-së).

I dënuar në shkallë të parë me aktgjykimin P nr. 403/2007 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 23 qershor 2010 për veprën penale Ndhimë në Shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 3 në lidhje me paragrafin 1 dhe nenin 25 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), i dënuar me kusht prej gjashtë (6) muajve burgim nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale në periudhën prej tre (3) viteve dhe me kompensim të dëmit deri në shumën prej 28.400 Euro të cilat duhet të paguhen brenda dy (2) viteve duke filluar nga data kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Duke vepruar lidhur me ankesën e paraqitur më 6 qershor 2011 nga avokati mbrojtës A. R. në emër të pandehurit R. K. kundër aktgjykimit P nr. 403/2007 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 23 qershor 2010, dhe duke marrë parasysh përgjigjen në ankesë nga Zyra e Prokurorit Special të Kosovës (PSRK-së) të paraqitur më 1 korrik 2011, dhe mendimin lidhur me ankesën nga Zyra e prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK-së) të paraqitur më 26 shtator 2011.

Pas mbajtjes së seancës publike më 19 qershor 2012, në prani të pandehurit R. K., avokatit mbrojtës A. R. dhe Prokurores Judit Tatrai përfaqësuese e PSRK-së, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur në të njëjtën ditë.

Sipas neneve 420 dhe në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), lëshon këtë:

## AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur më 6 qershor 2011 nga avokati mbrojtës A. R. në emër të pandehurit R. K. kundër aktgjykimit P nr. 403/2007 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 23 qershor 2010, **PRANOHET**.

Aktgjykimi P nr. 403/2007 i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i datës 23 qershor 2010, **NDRYSHOHET** 420 paragrafit 1 nën-paragrafit 4 në lidhje me nenin 426 paragrafin 1 të KPPK-së.

I pandehuri R. K., me shënime personale si më lart, **LIROHET** nga akuza për Ndhimë në Shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit në kundërshtim të nenit 339 në lidhje me nenin 25 të KPK-së, sipas nenit 390 paragrafit 3 të KPPK-së.

Të gjitha shpenzimet lidhur me procedurën penale kundër të pandehurit R. K. do të paguhen nga mjetet buxhetore sipas neneve 99, 100 dhe 103 të KPPK-së.

## ARSYETIM

### I. Historia e procedurës

Më 17 korrik 2007, është paraqitur aktakuza PP 480-5/2007 nga Prokurori Publik i UNMIK-ut duke akuzuar të pandehurit Sh. Sh. dhe S. H. B. për veprat penale Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit në bashkëkryerje në kundërshtim të neneve 23 dhe 339 paragrafëve 1 dhe 3 të KPPK-së (Pika 1), dhe Mashtrim në detyrë në bashkëkryerje në kundërshtim të neneve 23 dhe 341 të KPPK-së (Pika 3). R. K. është akuzuar për Ndhimë në Shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit në kundërshtim të neneve 25 dhe 339 të KPPK-së (Pika 2).

Me aktvendimin KA nr. 132/08 të datës 15 shkurt 2008, aktakuza është konfirmuar në tërësi duke ofruar disa ndryshime. Në veçanti, Pika 2 lexon si 'Ndhimë në Shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit në kundërshtim të neneve 25 dhe 339 paragrafëve 1 dhe 3 të KPPK-së e dënueshme sipas nenit 65 paragrafit 2 të KPPK-së'. Gjyqtari për konfirmim më tutje ka pranuar disa korrigjime të natyrës teknike.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 3 gusht 2009. Më 23 qershor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka lëshuar aktgjykimin P nr. 403/2007 me anë të cilit R. K. është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale Ndhimë në Shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit në kundërshtim të nenit 339 paragrafit 3 në lidhje me nenin 25 të KPK-së, sepse "[në] mes të 5 shkurtit 2004 dhe 12 nëntorit 2004, në Prishtinë R. K. në lidhje me prokurimin e 90 gomave Bridgestone nga Zyra e Presidentit të Kosovës, qëllimisht ka ndihmuar Sh. Sh. e cila në cilësinë e saj si person zyrtar dhe me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm i cili tejkalon 5000 Euro për të, ka shpërdorur pozitën e saj zyrtare në Zyrën e Presidentit të Kosovës, ka tejkalluar kufijtë e autorizimit të saj dhe nuk i ka kryer detyrat e saj zyrtare siç kërkohet me ligjin e Prokurimit Publik, përkatësisht, R. K. ka përgatitur dhe dorëzuar ofertat tepër të fryra, fatura të falsifikuara dhe dokumente mashtruese gjatë procedurës së

prokurimit në fjalë dhe pas kërkimit dhe pranimit të pagesave për gomat të cilat skajshmërisht kanë tejkuluar vlerën reale dhe para dërgimit të tyre të ZPK në shkelje të ligjit të prokurimit, ka ndihmuar në fshehjen e lokacionit të vërtetë të gomave të cilat kanë arritur në Prishtinë dhe ka përgatitur dokumentacion të falsifikuar lidhur me çmimin e transportimit të gomave, me të cilën ka shkaktuar dëme financiare në shumë prej 28.400 Euro.”

Gjykata i ka shqiptuar R. K. një dëmin me kusht prej gjashtë (6) muajve burgim nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në periudhën prej tre (3) viteve sipas nenit 41 paragrafit 1 pikës 1, neneve 42, 43 dhe 44 paragrafëve 1, 2 dhe 3 dhe nenit 66 paragrafit 2 të KPK-së. Përveç kësaj, ai obliguar që në mënyrë solidare të kompensoj dëmet e shkaktuara ndaj Zyrës së Presidentit të Kosovës (ZPK-së) deri në shumë prej 28.400 Euro brenda 2 (dy) viteve duke filluar nga data kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Dy të pandehurit e tjerë janë shpallë fajtor dhe janë dënuar.<sup>1</sup>

Më 6 qershor 2011, avokati mbrojtës A. R. ka paraqitur ankesë në emër të akuzuarit R. K. Prokurori Special (PSRK) ka paraqitur përgjigjen në ankesë më 1 korrik 2011. Mendimi i PSRK-së është regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme më 26 shtator 2011.

## **II. Parashtrësit e palëve në procedurën penale**

### **A. Ankesa e avokatit mbrojtës A. R. në emër të akuzuarit R. K.**

Mbrojtja i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që të ndryshoj aktgjykimin e kundërshtuar dhe të liroj të akuzuarin, ose të anuloj aktgjykimin dhe ta kthej lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Ai e bazon ankesën në bazat në vijim: shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal, dënimi mbi sanksionimin penal dhe vendimin mbi kërkesën pasurore.

### **Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 dhe paragrafit 2 të KPPK-së**

Mbrojtja pretendon se:

- Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është kundërthënës me arsyet e aktgjykimit.
- Aktgjykimin i mungon arsyetimi mbi faktet vendimtare.
- Faktet vendimtare të prezantuara në dispozitiv janë kundërthënëse me ato të prezantuara në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit në lidhje me provat e mbledhura dhe të prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

---

<sup>1</sup> Gjykata e Qarkut ka urdhëruar të pandehurit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës sipas nenit 102 paragrafit 1 të KPPK-së.

Sipas pikëpamjes së mbrojtjes, pohimet që R. K. kishte përgatitur fatura të rrejshme dhe dokumente të falsifikuara dhe se kishte ndihmuar në fshehjen e gomave pas sigurimit të tyre, nuk janë të arsyetuara në dispozitiv dhe nuk mbështeten me prova.

Përfundimisht, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka shkaktuar ndonjë dëm material. Për këtë arsye, nuk ka arsye të cilat mbështesin kompensimin e dëmit deri në shumën prej 28,400 eurosh.

### **Vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike sipas nenit 405, par. 2 dhe 3 të KPPK-së**

Mbrojtja pohon se Aktgjykimi mbështetet në vërtetimin e gabuar të fakteve, si pasojë e të cilit gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundime të gabuara. Avokati R. thekson se:

- Nuk qëndrojnë pohimet se R. K. ka falsifikuar dokumentet,
- I pandehuri ka përmbushur detyrimet e veta në përputhje me kontratën e nënshkruar, pa ankesa nga Zyra e Presidentit të Kosovës (ZPK).
- Ai ka blerë dhjetë goma për nevojat personale të Sh. Sh.
- Ai nuk është përfshirë në deponimin apo madje as në fshehjen e këtyre gomave.

Kjo dëshmi vërtetohet edhe me disa dëshmi të dëshmitarëve. Në fund, mbrojtja përmend gjendjen shëndetësore të R. K.

### **Shkelja e ligjit penal sipas nenit 404, par. 2 dhe 3 të KPPK-së**

Mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal në dëm të R. K., si pasojë e këtyre shkeljeve të përmendura më lart. Nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar. Gjukata e shkallës së parë nuk ka vepruar në mënyrë të ligjshme kur ka urdhëruar të pandehurin që ta kompensojë dëmin.

Për më tepër, gjendja shëndetësore e R. K. është përkeqësuar që nga pensionimi i tij ngase ai nuk mund të përballojë më as shpenzimet më të thjeshta për nevoja kryesore.

### **Vendimi mbi sanksionet penale dhe mbi kërkesën pronësore**

Mbrojtja pohon se vendimi mbi dënimin i gjykatës së shkallës së parë është i kundërligjshëm. Mbrojtja gjithashtu kundërshton vendimin mbi kërkesën pronësore.

#### **B. Përgjigjja e PSRK-së ndaj ankesës së mbrojtjes**

Prokurori special i propozon Gjykatës Supreme ta refuzojë ankesën si të pabazë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë.

#### **C. Mendimi i ZPShK-së**

Prokurori i shtetit i sugjeron Gjykatës Supreme që:

- Ta anulojë aktgjykimin e përgënjeshtuar dhe ta kthejë lëndën në shkallën e parë, vetëm pjesën që lidhet me vendimin mbi kërkesën pronësore sipas nenit 424, par. 5 të KPPK-së;
- Ta ndryshojë aktgjykimin duke e hequr nga dispozitivi fjalinë “ka ndihmuar në fshehjen e lokacionit të vërtetë të gomave të cilat janë siguruar në Prishtinë” sipas nenit 424, par. 4 dhe 426 të KPPK-së; dhe
- T’i refuzojë të gjitha arsyet tjera si të pabaza.

### **Vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së dhe shkelja e ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së**

Prokurori i shtetit është i mendimit se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në mënyrë të plotë provat e prezantuara nga palët, duke përfshirë edhe dëshmitë e dëshmitarëve. ZPShK-ja thekson se R. K. nuk kishte pasur përvojë të mëhershme me furnizimin me goma, dhe ishte ndihmuar nga Sh. Sh. duke bërë dy oferta; çmimi i gomave ishte fryrë së tepërmi me qëllim të sigurimit të përfitimit të paarsyeshëm material për të pandehurin në dëm të fondeve publike; R. K. kishte dorëzuar fatura të rrejshme dhe dokumente të falsifikuara gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit; arsyeja e vetme për blerjen e këtyre gomave ishte lakmia për të harxhuar sa më shumë para publike që kishte mundësi me qëllim të sigurimit të përfitimit të kundërligjshëm për të pandehurin K.

### **Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së dhe shkelja e ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së**

ZPShK-ja konstaton se pretendimi se nuk ka prova të cilat mbështesin faktin se R. K. kishte prezantuar fatura të rrejshme apo dokumente të falsifikuara është jomeritor. Është vërtetuar se R. K. kishte bërë këtë dhe i njëjti nuk ka mundur të jepte asnjë sqarim lidhur me lëshimin e dy faturave të transportit dy kompanive të ndryshme për të njëjtën ngarkesë me goma. Ky fakt konfirmon qëllimin e të pandehurit për t’i ndihmuar Sh. Sh. duke përgatitur dokumente të falsifikuara me qëllim të justifikimit të çmimeve jashtëzakonisht të larta.

Prokurori i shtetit konsideron se pohimi lidhur me fshehjen e gomave është i bazuar sepse në aktgjykim nuk ka asnjë sqarim të arsyetuar lidhur me atë se si dhe për çfarë arsye i dënuari i ka ndihmuar të bashkëpandehurit e tjerë në një fshehje të këtillë.

### **Vendimi mbi sanksionet penale dhe mbi kërkesën pronësore sipas nenit 406 të KPPK-së**

ZPShK-ja pajtohet me konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendimin mbi dënimin.

Lidhur me vendimin mbi kërkesën pronësore, Prokurori i shtetit vëren se Gjykata e Qarkut i kishte shqiptuar R. K. dhe Sh. Sh. gjobën për kompensimin e dëmit në shumën prej 28,400 eurosh.

Përkundër kësaj, ZPShK-ja nuk arriti ta gjejë askund në shkresat e lëndës këtë kërkesë pronësore, apo ndonjë sqarim të arsyetuar në aktgjykim lidhur me llogaritjen e këtij kompensimi. Ekziston vetëm një letër e datës 14 janar 2010 e dërguar nga Zyra e Presidentit të Kosovës (ZPK) tek Kryetari i trupit gjykues, në të cilën përmendet shuma prej 28,400 eurosh në emër të dëmit të pësuar. Sipas mendimit të Prokurorit të shtetit, gjykata e shkallës së parë është dashur ta shtjellojë këtë gjë në arsyetimin e aktgjykimit, në veçanti kur të kihet parasysh fakti se vlerësimi i çmimit të tregut të gomave nga ana e ekspertit të gjykatës të dëgjuar nga trupi gjykues ndryshon nga vlerësimi i bërë në këtë letër.

### **III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Ankesa e ngritur nga mbrojtja është e pranueshme. Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës konstaton se ankesa është e bazuar. I pandehuri R. K. lirohet nga akuza e ofrimit të ndihmës në shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, lidhur me nenin 25 të KPK-së, sipas nenit 390, par. 3 të KPPK-së.

#### **A. A është Gjykata Supreme e Kosovës kompetente për të vendosur**

Gjykata Supreme është gjykatë kompetente për të vendosur mbi këtë ankesë, në pajtim me nenin 26, par. 1 dhe nenin 398 të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, të datës 13 mars 2008 si dhe në përputhje me udhëzimet mbi caktimin e lëndëve.

#### **B. Pranueshmëria e ankesës**

Aktgjykimi është shpallur më 23 qershor 2010. I akuzuari R. K. ka pranuar aktgjykimin e kundërshtuar më 21 maj 2011. Fletëdërgesa për avokatin A. R. nuk mban kurrfarë date. Ankesa e mbrojtjes është dërguar përmes postës më datën 1 qershor ndërsa është regjistruar në gjykatën më datën 6 qershor 2011. Kjo ankesë i është komunikuar Prokurorit të PSRK-së më datën 22 qershor. Përgjigjja në këtë ankesë është dorëzuar më 1 korrik 2011. Ankesa është paraqitur brenda afatit nga ana e personit të autorizuar në pajtim me nenin 398, par. 1 dhe nenin 399, par. 1 të KPPK-së.

#### **C. Meritat e ankesës**

Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se ankesa është e bazuar sa i përket vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike sipas nenit 405, shkeljes së ligjit penal sipas nenit 404, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, par. 1, pikës 12 dhe vendimit mbi sanksionet penale dhe kërkesës pronësore, sipas nenit 406 të KPPK-së.

Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar si duhet gjendjen faktike lidhur me faturat të cilat pohohet se janë fryrë si dhe kontratën e mëhershme në mes të Sh. Sh. dhe R. K., duke shkelur nenin 405, par. 2 të KPPK-së. Faktet e vërtetuara nga Gjykata e Qarkut nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i pandehuri R. K. në mënyrë të kundërligjshme ka ndihmuar Sh. Sh. në kryerjen e veprës penale sipas nenit 339, par. 3, lidhur me nenin 25 të KPK-së.

Sipas opinionit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Qarkut ka nxjerrë konkluzione të gabueshme nga provat në dispozicion, veçanërisht gjetjet e ekspertit sa i përket vlerës së gomave. Në lëndën në fjalë, çmimi i tregut të gomave është vendimtarë, e jo vlera e tyre. Asnjë informatë e saktë nuk është mbledhur lidhur me çmimin mesatarë për goma të tilla e që nuk mund të gjendeshin në tregun e Kosovës në kohën përkatëse, dhe duhej të vlerësoheshin në shtetet tjera fqinje. Në ekspertizën e tij të datës 22 janar 2010, eksperti Xh. K. zhvilloi një krahasim të çmimeve në Kosovë, Maqedoni dhe Slloveni. Fatura e *emri i kompanisë ...* për 90 goma kapte shumën prej 47,820 euro. Ai vlerësoi që çmimet e tregut për 90 goma do të ndryshonin në mes të 18,955 dhe 24,094 euro. Ai arriti tek konkluzionet që të pandehurit e kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare duke e dëmtuar buxhetin e Kosovës deri në 23,790.80 euro.<sup>2</sup> Shuma e sugjeruar nga eksperti, edhe pse mund të jetë e saktë, nuk përfshin shpenzimet që duhet të shtohen në blerje, p.sh.: shpenzimet e transportit dhe tatimit. Si pasojë, çmimi i blerjes në të cilin Gjykata e Qarkut ka bazuar konkluzionet e mëtutjeshme nuk është vendimtare. Këto shpenzime shtesë do të duhet të merren parasysh gjatë llogaritjes së vlerësimit të përgjithshëm mbi blerjen e 90 gomave.

Veç kësaj, siç është vënë në pah në mënyrë të drejtë nga prokurori i shtetit, letra e parashtruar më 14 janar 2010 nga Departamenti (Divizioni) i Përfaqësimit Gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë me kryetarin e trupit gjykues lidhur me dëmtimin e materialit nga ZPK-ja për shkak të blerjes së gomave nuk mund të konsiderohet si e saktë. Për arritjen e shumës së 28,400 euro, Departamenti (Divizioni) ka bazuar llogaritjen e tij të faturës së datës 14.12.2005, nr. 70023918, me prejardhje nga çmimet e “Eurogomës” në vitin 2004,<sup>3</sup> dhe ka përfunduar që dallimi në mes të çmimit të fryrë dhe çmimit real është 28,400 euro. Veç kësaj, dyshimi ngritët në atë se nëse kjo letër mund të konsiderohet si kërkesë pasurore në kuptim të Kapitullit XII të KPPK-së. Gjithashtu, vlen të përmendet konfuzioni i treguar nga përfaqësuesi i ZPK-së gjatë gjykimit sa i përket qëllimit të tij të parashtror kërkesë pasurore dhe shumën e dëmit të vuajtur. Kryetari i kolegjit në mënyrë të vazhdueshme ia tërhoqi vëmendjen atij që të parashtror kërkesë pasurore. Më 12 tetor 2009, përfaqësuesi i ZPK-së është përkujtuar që propozimi për kërkesë pasurore mund të parashtrorhet jo

---

<sup>2</sup> Shih ekspertizën financiare të ekspertit Xh. K., N.I. *emri i kompanisë ...*, Ekspertiza e Grupit Punues, të datës 22 janar 2010, nr. i referencës 28/2009 (Dosja aktgjykimi i shqyrtimit gjyqësor)

<sup>3</sup> Letra e datës 14 janar 2010 nga Divizioni i Përfaqësimit Gjyqësor i Ministrisë së Drejtësisë: “çmimi për gomat e verës në shumën e 200 eurove, ndërsa për gomat e dimrit në shumën e 223 eurove të madhësisë 235/65-R17, gjithashtu bazuar në vitin 2009, çmimi prej 210 euro për goma të verës dhe 223 euro për gomat e dimrit sipas kontratës ishte për gomat e dimrit 40 x 588 = 23520, gomat e verës 50 x 486 = 24300, e që kushtojnë 47820 euro krahasuar me çmimin real, ZPRK-ja propozoi që bazuar në çmimin e tregut gomat e dimrit 40 x 223 = 8920 euro dhe gomat e verës 50 x 210 = 10500 = 19420 euro gjithsej.”

më vonë se përfundimi i shqyrtimit gjyqësorë.<sup>4</sup> Më 14 maj 2010, Kryetari i kolegjit përmendi që përfaqësuesi i ZPK-së ka parashtruar propozim lidhur me humbjen financiare të vlerësuar në shumën 20,000 euro, ndërsa prokurori deklaroi humbje financiare në shumën 40,000 euro. Kryetari i kolegjit kërkoi nga përfaqësuesi të verifikoj këtë pikë me eprorët e tij për seancën e ardhshme, e cila nuk është bërë sipas materialeve gjyqësore.

Sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme, kolegji i Gjykatës së Qarkut gjithashtu ka arritur në konkluzione të gabuara sa i përket qëllimit të R. K. të asistoj në kryerjen e veprës penale sipas nenit 25 të KPK-së. Gjetjet e gjykatës së shkallës së parë që kanë të bëjnë me lidhshmërinë e të pandehurit dhe të personit zyrtar, Sh. Sh., nuk janë bindëse. Aktgjykimit të kontestuar i mungon arsytimi kur thekson që “R. K. e ka njohur Sh. Sh. shumë më herët para se ai ka vendosur ofertat në prokurim dhe ai e ka ditur që Sh. Sh. ishte person zyrtar.”<sup>5</sup> Gjykata e Qarkut nuk ka vërtetuar qëllimin dhe njohurinë e R. K. lidhur me keqpërdorimin e autorizimeve të Sh. Sh. në dobi të të pandehurit.

Referencë e vetme në pjesëmarrjen e R. K. në procedurën e tenderit për bibliotekën e Universitetit dhe të përkrahjes së Sh. Sh. ta ndihmojë atë në aplikim mund më së miri të ofroj shpjegimet e qëllimit e të fundit për të vepruar në dobi të të pandehurit. Megjithatë, është vërejtur që kjo ofertë nuk është fituar nga R. K. Fakti që Sh. Sh. ka blerë dhjetë goma për përdorim personal nga R. K. mundet vetëm të nënvizoj gatishmërinë e saj në dobi të të pandehurit, por nuk lejon në tërheqjen e çfarëdo konkluzioni të arsyeshëm lidhur me qëllimin penal të K. Arsytimi i gjerë i aktgjykimit të atakuar është i lidhur me rolin e Sh. Sh. Qëllimi i të pandehurit të asistoj Sh. Sh. në manipulimet e paligjshme të procedurës së ofertës të gomave nuk është dëshmuar.

Për më tepër, Gjykata Supreme nuk pajtohet me gjetjet e Gjykatës së Qarkut të përmendura në dispozitiv që “...R. K. ka përgatitur dhe dorëzuar oferta tepër të fryra, fatura false dhe dokumente mashtruese në drejtim të procedurës së prokurimit në fjalë dhe pasi që ka kërkuar dhe pranuar pagesën për gomat që ishte shumë larg vlerës së vërtetë të gomave dhe shumë më herët së dërgesës së tyre në ZPK duke shkelur ligjin e prokurimit, ka asistuar në zhdukjen e vendndodhjes së vërtetë të gomave menjëherë pasi që janë dorëzuar në Prishtinë ...”. Gjykata e shkallës së parë nuk e përmendur fare në arsyetimin e aktgjykimit përfshirjen e R. K. në zhdukjen e gomave.<sup>6</sup> Jashtë shkresave të lëndës, është vërtetuar që E. L. i është dhënë detyra nga

---

<sup>4</sup> Shih lëndën P nr. 403/2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të datës 12 tetor 2009, 6 janar 2010; procesverbali i seancës për konfirmim i datës 13 shkurt 2008, faqet 2 dhe 3

<sup>5</sup> Shih lëndën P nr. 403/2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Aktgjykimi i shkallës së parë, faqe 12

<sup>6</sup> Shih lëndën P nr. 403/2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Aktgjykimi i shkallës së parë, 23 qershor 2010, faqe 24: “Dëshmitari **E. H.** si shefi logjistikës në Zyrën e Presidentit të Kosovës, [...] Ky dëshmitar konfirmoi informatën që gomat janë pranuar përafërsisht në tetor apo nëntor të vitit 2004 dhe janë ruajtur në lokalet private të F. K. ish trupprojës së Presidentit për shkak të mungesës së hapësirës në depo. Arsyeja për dërgimin e gomave në këtë vend të veçantë ishte që “*Ne nuk duhet të*



E. H. të aranzhoj ruajtjen e gomave, me kërkesë të Sh. Sh.,<sup>7</sup> dhe që i pandehuri në kurrfarë mënyre nuk ka marr pjesë në zhdukjen (fshehjen) e tyre.

Për më tepër, kolegjit i Gjykatës Supreme gjen se arsyetimi në dispozitiv është i paqartë sa i përket shumës së kompensimit dhe konsideron se është bërë shkelje e nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së. Gjykata e Qarkut e ka dënuar R. K. (dhe Sh. Sh.) që “në mënyrë të përbashkët dhe të ndarë të kompensojnë dëmin e shkaktuar ndaj ZPK-së në shumën e 28.400 euro brenda 2 (dy) viteve duke filluar nga data kur aktgjykimi e merr formën e prerë”.<sup>8</sup>

Kjo pjesë e dispozitivit është konfuze dhe tërësisht e paqartë pasi që trupi gjykues urdhëroi pagesën e kompensimit të dëmit sipas pjesës mbi dënimin. Gjykata Supreme vëren që qartësia e dispozitivit është e rëndësishme dominuese, dallimi i pa të meta duhet të bëhet në mes të pjesës mbi dënimin dhe tjera që i referohet kërkesës pasurore. Për më tepër, nuk ekziston dispozitë relevante e përmendur në dispozitiv, si bazë e detyrimit të kompensimit të dëmit deri në 28,400 euro. Në fund, asnjë llogaritje precize nuk mund të gjendet në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar.<sup>9</sup>

Në mënyrë të ngjashme ndodhi shkelja e ligjit penal në kundërshtim të nenit 404, paragrafit 4 të KPPK-së. Përcaktimi i gabuar i shumës së dëmit gjithashtu ka ndikim në përcaktimin ligjor të veprës penale sipas nenit 339, paragrafit 3 të KPK-së, pasi që nuk është vërtetuar me vendosmëri që përfitimi material i të pandehurit ka tejkaluar shumën e 5,000 eurove. Pasi që ky fakt nuk është përcaktuar në mënyrë të duhur në shkallën e parë, dispozita e saktë e aplikueshme në shkallë mund të ishte ekskluzivisht neni 339, paragrafi 1 i KPK-së, i shkarkuar prej rrethanës rënduese të paraparë sipas paragrafit 3.

Gjykata Supreme konstaton që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka vendosur mbi sanksionet penale dhe kërkesën pasurore si pasojë të shkeljeve të përmendura, kështu duke kryer shkelje sipas nenit 406 të KPPK-së. Ky kolegji gjithashtu vëren që sipas aktgjykimit të atakuar, kompensimi i dëmit duhet të paguhet

---

*paguajmë qira.*” Dëshmitari gjithashtu përmendi që lista e inventarit të gomave në pyetje ishte përkthyer dhe që 20 gomat e reja ishin përdorur për të zëvendësuar të vjetrat.”; ibid faqe 31

<sup>7</sup> Shih raportin mbi bastisje e datës 28.07.2006, lënda nr. 2006 ZX 001, bastisja e bërë në shtëpinë e F. K. dhe lokalet private dhe afariste të Sh. Sh. (lokacion i njëjtë), 77 goma (llojet bridgestone dhe continental) ishin ruajtur në dhomën e banesës së F. K. (Dosja UNMIK dosja hetuese 1/9, faqe 480); Shih lëndën P nr. 403/2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 15 tetor 2009, faqet 9 dhe në vijim, dëshmia e E. H.; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 22 tetor 2009, faqet 14 dhe në vijim, dëshmia e E. L., faqet 24 dhe në vijim (Dosja e kaltër EULEX Sh. Sh., nga aktakuza).

<sup>8</sup> Shih lëndën P nr. 403/2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, aktgjykimi i shkallës së parë, 23 qershor 2010, faqe 5.

<sup>9</sup> Shih lëndën P nr. 403/2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Aktgjykimi i shkallës së parë, 23 qershor 2010, faqe 12: “Gjykata vërtetoi faktet në vijim: [...] Çmimi i tregut për gomat në fjalë ishte në fakt shumë i ultë se sa çmimi i ofruar në këta dy tenderë. Sipas mendimit të ekspertit Xh. K. duke supozuar kufirin e përfitimit të arsyeshëm për importuesin, vlera e përgjithshme e 90 gomave të verës dhe të dimrit të llojit Bridgestone do të ishte 24.029,20 euro. Krahasimi i kësaj vlere me vlerën e përgjithshme të paguar nga Zyra e Presidentit të Kosovës - 47.820,00 euro shpie në një konkluzion logjik që çmimi është fryrë tej mase, duke shfrytëzuar mundësinë për të bërë përfitim domethënës në shpenzime publike, përkundër faktit që Zyra e Presidentit të Kosovës nuk ka pasur lokale të përshtatshme në dispozicion të saj.”; shih gjithashtu faqet 33, 34 dhe 36.

‘në mënyrë të përbashkët dhe ndarazi’ nga R. K. dhe Sh. Sh., edhe pse R. K. ishte i dënuar vetëm për Ndhimë në Shpërdorimin e Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit sipas nenit 25 të KPK-së.

Prandaj, kolegji i nënvizuar përfundon që duke marr parasysh provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk mund të vërtetohet që R. K. ka kryer vepër penale për të cilën është akuzuar. Pasi që nuk mund të mblidhet në shkallën e parë dhe përsëritja e provave do të ishte e panevojshme, kolegji i nënvizuar konstaton që kthimi i lëndës në shkallën e parë në rigjykim nuk do të shërbej interesave të pandehurit apo të interesit të drejtësisë.

Duke marr parasysh të lartpërmendurën, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të aplikoj parimin *in dubio pro reo* në shkallë dhe të liroj të pandehurin në pajtim me nenin 390 paragrafin 3, i lidhur me nenet 420, paragrafi 1, nën-paragrafi 4 dhe 426, paragrafi 1 i KPPK-së. Faktet e vërtetuara nuk mjaftojnë për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit R. K.

Për më tutje, kolegji i Gjykatës Supreme konsideron që neni 419 i KPPK-së nuk është i aplikueshëm pasi që arsyet që e kanë drejtuar vendimin e saj janë të ‘natyrës së pastër personale’ prandaj edhe nuk mund të aplikohen në dobi të të pandehurve të tjerë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës bazohet në nenet 99 dhe ato vijuese të KPPK-së. I pandehuri është liruar dhe duhet të lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës së shkallës së parë.

Prandaj, është vendosur si në dispozitiv.

**Kryetari i kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
Horst Proetel, Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtar i kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
Gerrit-Marc Sprenger, Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtare e kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
Emine Mustafa, Gjyqtare e Gjykatës Supreme

**Procesmbajtëse:**

\_\_\_\_\_  
Chiara Rojek, Zyrtare Ligjore

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**19 qershor 2012**  
**Ap – Kz 325/11**  
**Prishtinë**